



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 340/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Jelena Stojanoviç – Drejtoreshë e Shërbimeve Komunale në Graçanicë, paraqitur kundër Subjekteve politike për shkak të mbajtjes së tubimit në rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet poshtë si e pa rregullt ankesa e Jelena Stojanoviç – Drejtoreshë e Shërbimeve Komunale në Graçanicë .

Arsyetim

Me datën 25.10.2013, Jelena Stojanoviç, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, në vendin shumë të frekuentuar në afërsi të monumentit të Gracanicës afër shtëpisë së shëndetit afër rrugës kryesore Prishtinë-Gjilan, është mbajtur një tubim publik në ora 14:00, në afërsi të spitaleve dhe vendeve ku do të pengonte veturave të ambulancës dhe do të prishte qetësin e pacienteve të hospitalizuar. Sipas saj organizatori i tubimit ka shkelur ligjin për tubimet publike për arsye se tubimi është mbajtur në vend të papërshtatshëm ku me atë rast ka shkaktuar kolaps në trafik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pa rregullt

Me ankesën e parashtruar nga Jelena Stojanoviç, pretendohet se në vendin shumë të frekuentuar në afërsi të monumentit të Gracanicës afër shtëpisë së shëndetit afër rrugës kryesore Prishtinë-Gjilan, është mbajtur një tubim publik në ora 14:00, në afërsi të spitaleve dhe vendeve ku do të pengonte veturave të ambulancës dhe do të prishte qetësin e pacienteve të hospitalizuar. Sipas saj organizatori i tubimit ka shkelur ligjin për tubimet publike për arsye se tubimi është mbajtur në vend të papërshtatshëm ku me atë rast ka shkaktuar kolaps në trafik.

PZAP-i konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu shqyrtuar, prandaj ankesa vlerësohet si e parregullt bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 340/2013 më datën 31.10.2013

Kryesuesi i Panelit

Xhevdet Abazi



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*